



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2636/ 3 prot.

Datë 15 .11.2023

V E N D I M
Nr. 1158 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84207-10-18-2023, me objekt “Blerje materiale për diagnostikimin e DSA Cerebrale dhe Trombektomi”, me fond limit: 65,870,925.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Trimed” SHPK me NIPT K51612031J dhe adresë: “Autostrada Tiranë - Durrës, Km 10, Zone kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal “Memorial” Fier me adresë: Qendër, Afrimi i Ri, Rruga “Daullas Grecalli” Nr 17, Daullas, Fier,

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84207-10-18-2023, me objekt

“Blerje materiale për diagnostikimin e DSA Cerebrale dhe Trombektomi”, me fond limit: 65,870,925.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

II.2. Në datën 27.10.2023 operatori ekonomik “Trimed” SHPK nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2023/3544 dhe me nr. 2636/2023 prot., datë 27.10.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 1346/4 datë 01.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2636/2 prot., datë 03.11.2023 është depozituar në KPP vendimi nr.1, datë 31.10.2023, i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të Autoritetit Kontraktor, për shqyrtimin e ankesës, i cili e ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë vijon:

“[...] Vlerësimi dhe gjykimi i KSHA

Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 16272020, “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, DST-së, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, KSHA, gjykon se:

I. Sa i përket pretendimit të OE në lidhje me përdorimin e gjuhës Anglisht ose Shqip ne procedurën e prokurimit në fjalë, nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar në SPE konstatojme se në pikën 4.7 të Njoftimit të Kontratës është përcaktuar si më poshtë:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X Anglisht X

Gjithashtu në pikën 2.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit është përcaktuar:

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave (kur eshte e aplikueshme).

Kriteri 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim te leshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi MAH për Shqipërinë (ku të provohet dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet te cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje materialet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te o ertave, dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

Kriteri 2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten Katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Sa më sipër verifikuar nga DST, konstatohet se në piken 4.7 te Njoftimit te Kontrates, AK ka përzgjedhur gjuhët Shqip dhe Anglisht si gjuhë të pranueshme në të cilat mund të hartohen ofertat ndërkohë që në Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kriteri 2.3.5 dhe Kriteri 2.3.6, AK ka kërkuar që keto dokumente duhet të jenë të përkthyer por pa përcaktuar që përkthimi duhet të jetë në gjuhën Shqipe apo Angleze. Në këtë rast AK sqaron OE se të gjithë dokumentet që do të dorëzohen si pjesë e dosjes së ofertës që nuk janë në gjuhën Shqipe ose Angleze në zbatim të pikes 4.7 te Njoftimit te Kontrates, duhet të përkthehen në gjuhën Shqipe ose Angleze.

Sa i përket Kriterit 2.3.7 ku AK percakton se “...pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen” KSHA gjykon, se ky kriter duhet modifikohet në zbatim te nenit 24, pika 2 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” ku parashikohet se:

“Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht”

Për sa është argumentuar më sipër, pretendimi i OE qëndron.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 1346/4 datë 01.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2636/2 prot., datë 03.11.2023 është depozituar në KPP vendimi nr.1, datë 31.10.2023 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të Autoritetit Kontraktor për shqyrtimin e ankesës i cili e ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë vijon:

“[...] Vlerësimi dhe gjykimi i KSHA

Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 16272020, “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, DST-së, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, KSHA, gjykon se:

I. Sa i përket pretendimit të OE në lidhje me përdorimin e gjuhës Anglisht ose Shqip ne procedurën e prokurimit në fjalë, nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar në SPE konstatojme se në pikën 4.7 të Njoftimit të Kontratës është përcaktuar si me poshtë:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X Anglisht X

Gjithashtu në pikën 2.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit është përcaktuar:

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave (kur është e aplikueshme).

Kriteri 2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të leshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi MAH për Shqipërinë (ku të provohet dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

Kriteri 2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë

emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Sa më sipër verifikuar nga DST, konstatohet se në piken 4.7 te Njoftimit te Kontrates, AK ka përzgjedhur gjuhët Shqip dhe Anglisht si gjuhë të pranueshme në të cilat mund të hartohen ofertat ndërkohë që në Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kriteri 2.3.5 dhe Kriteri 2.3.6, AK ka kërkuar që keto dokumente duhet të jenë të përkthyer por pa përcaktuar që përkthimi duhet të jetë në gjuhën Shqipe apo Angleze. Në këtë rast AK sqaron OE se të gjithë dokumentet që do të dorëzohen si pjesë e dosjes së ofertës që nuk janë në gjuhën Shqipe ose Angleze në zbatim të pikes 4.7 te Njoftimit te Kontrates, duhet të përkthehen në gjuhën Shqipe ose Angleze.

Sa i përket Kriterit 2.3.7 ku AK percakton se “...pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen” KSHA gjykon, se ky kriter duhet modifikohet në zbatim te nenit 24, pika 2 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” ku parashikohet se:

“Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht”

Për sa është argumentuar më sipër, pretendimi i OE qëndron.”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Trimed” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Trimed” SHPK për pikën 2.3.9 të dokumenteve të tenderit, lidhur me paraqitjen e mostrave për të cilën kërkon që: “AK ta modifikojë DST duke e hequr kriterin për paraqitjen e mostrave, duke hapur në këtë mënyrë garën për një pjesëmarrje të të gjithë operatorëve ekonomikë shqiptarë dhe të huaj si dhe duke mos krijuar kosto të dubluar për pjesëmarrje në procedurë dhe as duke e komplikuar atë.”, KPP vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderi. “kapaciteti teknik” pika 2.3.9 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Kriteri 2.3.9 Për artikujt e mëposhtëm duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 24.11.2023 ne oren 09:00.

Lista e Mostrave:

Nr.	Pershkrimi
2	Angiographic Vertebral Catheter 5 fr, length 100 cm
5	Angiographic Simmons 2 Catheter, 5 fr, length 100 cm
7	Angiographic aorto and vena cava Catheter, 5Fr pigtail, length 65-90cm.

8	<i>Hydrophilic angeled guideëire standard, 0.035", length 150-180 cm</i>
14	<i>Femoral Introducer set 6 Fr, 10-11 cm</i>
18	<i>Mainfold, 3-port OFF version rotating adapter male right, resistant up to 35 bar (500 psi), transparent housing for visual control, steril. (Manifold me 3-porta modeli OFF me pershtates rrotullues mashkull te djathte, rezistent deri në 35 bar (500 psi), trup transparente për kontrollin vizual, steril).</i>
20	<i>Stent Karotid me vetezgjerrim ne forme konike per pershtatje ne enet karotide te bifurkuara, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat kinike 10x7mm me gjatesi stente 30cm dhe 40cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch.</i>
25	<i>Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014" dhe 0.018". Permasa e rrjetes 5mm, gjatesia e fijes 320cm.</i>
31	<i>Guideëire 0.035", prej nitinoli, shaft fleksibel, gjatësi 180 – 185 cm, majë më të drejtë, me gjatësi maje 14-15 cm</i>
33	<i>150 ml Syringe Medrad Mark 7 or equivalent</i>
41	<i>Shiringë e njëpërdorimeshe për lidhje me kolektorë dhe kateterë, për injektim me dorë të kontrastit, heparinës, solucionit të kripur dhe lëngjeve të tjera, prej material polikarbonati për të siguruar vizualizimin e lehtë të niveleve të lëngut dhe injektim të saktë, I.D 0,100 inç. 10 ml blu).</i>
42	<i>Pajisje fryrese 30atm, ventil 3-rrugesh, pershtates-Y, age metalike per futjen e e guides dhe torku.</i>
45	<i>Pressure Infusion Bag, 500 - 3000 ml ëith manometer</i>
47	<i>PTA Balloon Catheter - Balon Kateter PTA me diameter 5-6mm dhe me gjatesi 20-30mm</i>
48	<i>Sheath Introducer Femoral 8Fr 11-25cm</i>
50	<i>Kateter Guiding 8F JR4</i>
54	<i>Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 4mm dhe gjatesi 40mm, gjatesi totale e stentit 50-52mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 4.0mm, kompatible me mikrokateter 0.021"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrhjes.</i>

59	<i>Mikrokateter me gjatesi pune 150-160cm dhe me diameter te brendshem 0.017-0.027inch, me maje te drejte, me sgment te bute distal 6cm.</i>
----	--

Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë zyrës së protokollit, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për këtë procedurë prokurimi dhe jo para datës 24.11.2023 , në orën 09:00.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

III.2.2 Në shtojcën nr. 5 të dokumenteve të tenderit *“Formulari i specifikimeve teknike”* autoriteti kontraktor ka parashikuar:

“Materiale për dignostikimin e DSA Cerebrale dhe Trombektomi”

Nr.	Pershkrimi	Njesia
1	Angiographic Vertebral Catheter 4 Fr, length 100 cm	Cope
2	Angiographic Vertebral Catheter 5 fr, length 100 cm	Cope
3	Angiographic Simmons 1 Catheter, 4 Fr, length 100 cm	Cope
4	Angiographic Simmons 1 Catheter, 5 fr, length 100 cm	Cope
5	Angiographic Simmons 2 Catheter, 5 fr, length 100 cm	Cope
6	Angiographic Visceral C1/C2/C3 Catheter, 5 fr, length 65-90 cm	Cope
7	Angiographic aorto and vena cava Catheter, 5Fr pigtail, length 65-90cm.	Cope
8	Hydrophilic angeled guideëire standard, 0.035", length 150-180 cm	Cope
9	Hydrophilic angeled guideëire, stiff 0.035", length 150-180 cm	Cope
10	Hydrophilic angeled guideëire, stiff 0.035", length 260 cm	Cope

11	Hydrophilic angeled guideëire standard, 0.035", length 260 cm	Cope
12	Femoral Introducer set 4 Fr, 7 -11cm	Cope
13	Femoral Introducer set 5 Fr, 10-11 cm	Cope
14	Femoral Introducer set 6 Fr, 10-11 cm	Cope
15	Femoral Introducer set 6 Fr, 23-25 cm	Cope
16	Femoral Introducer set 6 Fr, 45-90 cm	Cope
17	Femoral Introducer set 9 Fr, 45-90 cm	Cope
18	Mainfold, 3-port OFF version rotating adapter male right, resistant up to 35 bar (500 psi), transparent housing for visual control, steril. (Manifold me 3-porta modeli OFF me pershtates rrotullues mashkull te djathte, rezistent deri në 35 bar (500 psi), trup transparente për kontrollin vizual, steril).	Cope
19	Stent Karotid me vetezgjerim ne formekonik per pershtatje ne enet karotide te bifurkuara, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat kinike 8x6mm me gjatesi stente 30cm dhe 40cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch.	Cope
20	Stent Karotid me vetezgjerim ne forme konike per pershtatje ne enet karotide te bifurkuara, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat kinike 10x7mm me gjatesi stente 30cm dhe 40cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch.	Cope
21	Stent Karotid me vetezgjerim, i drejte, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat e drejta 6 dhe 7mm me gjatesi 20;30;40;60cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch.	Cope
22	Stent Karotid me vetezgjerim, i drejte, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat e drejta 8;9 dhe 10mm me gjatesi 20;30;40;60cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch.	Cope

23	Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014" dhe 0.018". Permasa e rrjetes 3mm, gjatesia e fijos 320cm.	Cope
24	Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014" dhe 0.018". Permasa e rrjetes 4mm, gjatesia e fijos 320cm.	Cope
25	Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014" dhe 0.018". Permasa e rrjetes 5mm, gjatesia e fijos 320cm.	Cope
26	Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014" dhe 0.018". Permasa e rrjetes 6mm, gjatesia e fijos 320cm.	Cope
27	Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014" dhe 0.018". Permasa e rrjetes 7mm, gjatesia e fijos 320cm.	Cope
28	Kateter me dy balona okluzioni prej gome elastomerike per mbrojtje cerebrale, gama e okluzionit te balonave deri ne 13mm baloni proximal dhe deri ne 6mm baloni distal, markues baloni ne distance 6cm, diametri i brendeshem i kanalit te punes 2.12mm, minimum sheath introducer 9F, kompatibel me guideëire 0.035".	Cope
29	Guideëire 0.014", prej nitinoli, gjatësi 180 – 185 cm, majë me kënd 15 gradë, gjatësi maje 5-6 cm	Cope
30	Guideëire 0.018", prej nitinoli, gjatësi 180 – 185 cm, maje te drejte, gjatësi maje 2-3 cm	Cope
31	Guideëire 0.035", prej nitinoli, shaft fleksibel, gjatësi 180 – 185 cm, majë më të drejtë, me gjatësi maje 14-15 cm	Cope
32	Angiography pack - Reinforced Angio Drape 240 x 300 cm ëith tëo sided PE clear film (ëaterproof, high absorption ability), - Tray 30x30x5 cm, - Cup 60 m, - Boël 500 ml, - Table Cover 140x150 cm, - Gauze 10x10 cm, - Protective cover 80x110 cm, - Image intensifier cover ëith elastic fixation, - Sponge stick, - Coats XL x 2, - Scalpel	Cope

33	150 ml Syringe Medrad Mark 7 or equivalent	Cope
34	Hemostasis Y-connector ëith and ëithout pressure monitoring line push click/push pull/screë type (Lidhes tip Y per hemostaze me dhe pa linje anesore per monitorimin e presionit shty kercit/ shty terhiq/filetim)	Cope
35	Syze mbrojtëse ndaj rrezeve X, me mbrojtje anësore të lehta, Indeksi i thyerjes në 20°C 1579, Niveli i mbrojtjes përpara =0,75 mmPb, Niveli i mbrojtjes anësore =0,50 mmPb, Toleranca e dioptrës së lenteve +0,05 – (-0,07) D, Shkalla e transmetimit të lenteve jo më pak se 80 përqind midis 500-600 nm, Vlera e ekuivalentit të dobësimit konstatuar nën tensionin e tubit me rreze x 120 kV, Transmetimi ndriçues (d=6,0 mm) 90,5% Plumb (Pb) 48%, Oksid plumbi (PbO) ≥ 22%, Oksid metalik i rëndë ≥ 23%, Dendësia në g/cm ³ ≥ 3,13, Rezistenca ndaj UV: pa humbje transmetimi pas ekspozimit të vazhdueshëm ndaj UV, Konform me standartet: DIN ISO 719 HGB 3; IEC 61331-2 dhe DIN 6841.	Cope
36	Mrojtese plumbi qafe me mbyllje vlekroni, E përshtatshme për mbrojtjen e tiroideve dhe kraharorit, Shtresa Mbrojtëse: 0.50 mm Pb, Permase 38-46 me lartesi 6cm, Konform me standartet: (EU) 2016/425; IEC 61331-3: 2014 dhe EN ISO 13688:2013.	Cope
37	Mbrojtëse për kokën, Shtresa mbrojtësë 0.50mm Pb	Cope
38	Mbrojtese plumbi e vezoreve, Përmasat: 18x24 cm (Mesatare), Shtresa mbrojtëse: 1mm Pb, Konform me standartet: (EU) 2016/425; IEC 61331-3: 2014 dhe EN ISO 13688:2013.	Cope
39	Mbrojtese plumbi per skrotum, Përmasat: 11x18 cm, Shtresa mbrojtëse: 1,00 mm Pb, Konform me standartet: (EU) 2016/425; IEC 61331-3: 2014 dhe EN ISO 13688:2013.	Cope
40	Mbrojtese Gonad (per perdorim ne rastet kur nuk mund te perdoret mbrojtësja e skrotumit ose vezoreve), Set me tre përmasa: E vogël 10x12 cm; Mesatare: 14 x 17 cm; E madhe: 18 x 21 cm, Shtresa mbrojtëse: 1.0mm Pb, Konform me standartet: (EU) 2016/425; IEC 61331-3: 2014 dhe EN ISO 13688:2013.	Cope

41	Shiringë e njeperdorimeshee për lidhje me kolektorë dhe kateterë, për injektim me dorë të kontrastit, heparinës, solucionit të kripur dhe lëngjeve të tjera, prej material polikarbonati për të siguruar vizualizimin e lehtë të niveleve të lëngut dhe injektim të saktë, I.D 0,100 inç. 10 ml blu).	Cope
42	Pajisje fryrese 30atm, ventil 3-rrugesh, pershtates-Y, age metalike per futjen e e guides dhe torku.	Cope
43	Përparëse mbrojtëse Plumbi me mbyllje velkroni për personelin, Mrojtje e plotë përpara dhe mbrapa me gjatësi të plotë, Mbrojtje e përforcuar në shpatulla, Përmasat: 110 x 60 cm, Shtresa mbrojtëse përpara: 0.50 mmpb, Shtresa mbrojtëse mbrapa: 0.25mmpb, Të paktën 10 cm mbivendosje kur vishet, Konform me standartet: (EU) 2016/425; IEC 61331-3: 2014 dhe EN ISO 13688:2013.	Cope
44	Përparëse mbrojtëse Plumbi me mbyllje velkroni për personelin, Mrojtje e plotë përpara dhe mbrapa me gjatësi të plotë, Mbrojtje e përforcuar në shpatulla, Përmasat: 120 x 60 cm, Shtresa mbrojtëse përpara: 0.50 mmPb, Shtresa mbrojtëse mbrapa: 0.25mmPb, Të paktën 10 cm mbivendosje kur vishet, Konform me standartet: (EU) 2016/425; IEC 61331-3: 2014 dhe EN ISO 13688:2013.	Cope
45	Pressure Infusion Bag, 500 - 3000 ml ëith manometer	Cope
46	Sistem per kapjen dhe terheqjen e materialeve te humbura gjate procedurave intervencionuese, me lak radiopak me kend 90 grade ne raport me trupin e sistemit me perberje nitinoli, lak me diameter 20-21 mm dhe gjatesi totale 120-122 cm dhe gjatesi te kateterit 102-105 cm, kompatibel me kateter 6F	Cope
47	PTA Balloon Catheter - Balon Kateter PTA me diameter 5-6mm dhe me gjatesi 20-30mm	Cope
48	Sheath Introducer Femoral 8Fr 11-25cm	Cope
49	Age seldinger	Cope
50	Kateter Guiding 8F JR4	Cope

51	Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 3mm dhe gjatesi 20mm, gjatesi totale e stentit 30-32mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 1.0 deri ne 3.0mm, kompatible me mikrokateter 0.017"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrjes.	Cope
52	Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 3mm dhe gjatesi 40mm, gjatesi totale e stentit 50-52mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 1.0 deri ne 3.0mm, kompatible me mikrokateter 0.017"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrjes.	Cope
53	Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 4mm dhe gjatesi 20mm, gjatesi totale e stentit 30-32mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 4.0mm, kompatible me mikrokateter 0.021"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrjes.	Cope
54	Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 4mm dhe gjatesi 40mm, gjatesi totale e stentit 50-52mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 4.0mm, kompatible me mikrokateter 0.021"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrjes.	Cope
55	Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 6mm dhe gjatesi 20-25mm, gjatesi totale e stentit 31-37mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 5.5mm, kompatible me mikrokateter 0.021"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrjes.	Cope
56	Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 6mm dhe gjatesi 40mm, gjatesi totale e stentit 47-50mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 5.5mm, kompatible me mikrokateter 0.021"-0.027", gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrjes.	Cope

57	Kateter mbeshtetes intrakranial 5F/6F, I drejte me gjatesi 125-130cm, gjatesi distale elastike 8cm	Cope
58	Hydrophilic Guideëire 0.014" gjatesi totale 205-210cm, gjatesi e spirales jo me pak se 5cm.	Cope
59	Mikrokateter me gjatesi pune 150-160cm dhe me diameter te brendshem 0.017-0.027inch, me maje te drejte, me sgment te bute distal 6cm.	Cope
60	Kateter aspirimi per infarktin akut ishemik, gjatesi 132-135cm, spiral dhe i veshur prej nitinoli gjate gjithë gjatesise, diameter i brendshem 0.068inch dhe diameter i jashtem 0.083inch.	Cope
61	Kateter aspirimi per infarktin akut ishemik, gjatesi 132-135cm, spiral dhe i veshur prej nitinoli gjate gjithë gjatesise, diameter i brendshem 0.071inch dhe diameter I jashtem 0.0855inch.	
62	Kateter per akses distal me gjatesi jo me pak se 120cm.	Cope
63	Popme vakumi per aspirim trombi	Cope
64	Tub aspirimi me gjatesi 112-115inch dhe diameter te brendshem 0.110"	Cope
65	Sistem per kapjen dhe terheqjen e materialeve te humbura gjate procedurave intervencionuese, me lak radiopak me kend 90 grade ne raport me trupin e sistemit me perberje nitinoli, lak me diameter 2-7 mm dhe gjatesi totale 150-200 cm dhe gjatesi te kateterit 150-15 cm, Catheter Size Distal 2.3Fr - Proximal 3Fr.	Cope

III.2.3. Në kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me këtë pretendim autoriteti kontraktor ka argumentuar: *“Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues konstatohet se nga ana e tij pretendohet se vendosja e këtij kriteri është diskriminues dhe kufizues për garën nga ana e Autoritetit Kontraktor në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe me praktikën e konsoliduar të KPP. OE ankimues në këtë ankesë ngre pretendime edhe në emër të OE ndërkombëtar që ftohen të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi dhe ky kriter do të*

ishite diskriminues dhe do të kufizonte garën e kësaj procedure Prokurimi. OE ankimues sjell si prova argumentuese Vendime të KPP-së që ju referohen procedurave të prokurimit të një natyre dhe vlere të ndryshme nga procedura e prokurimit në fjalë dhe i parashtron ato si Vendime në të cilat AK duhet të bazohet kur harton specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit duke anashkaluar Ligjin dhe aktet nënligjore për prokurimin publik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar në SPE, Shtojca 7, pika 2.3.9 e Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, rezulton se AK e ka hartuar këtë kriter konform Nenit 40, pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: Autoriteti enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit, dhe ose

b) fotografitë apo katalogët teknike, dhe ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike...

Neni 40/6 i VKM 28572021, i lë mundësinë autoritetit kontraktor, që në vlerësimin e tij, në varësi të specifikave të objektit të prokurimit të kërkojë mostra, dhe/ose, fotografi/kataloge dhe/ose, rezultate të testimeve zyrtare. Pra, nga leximi literal i dispozitës keto kushte nuk përjashtojnë njëra tjetrën (pasi përdoret termi dhe/ose), që do të thotë autoriteti ka tagrin që të vlerësojë dhe kërkojë paraqitjen e mostrave për artikuj të caktuar, si edhe kataloge apo rezultate të testimeve zyrtare. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor është bazuar në kërkesat e dispozitës ligjore në fjalë.

Gjithashtu bazuar në Udhëzimin e APP, në Procesverbalin mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, AK përveç bazes ligjore ku është bazuar mbi hartimin e këtij kriteri ka argumentuar teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave si vijon “Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK” Duke qene se materialet objekt prokurimi kane nje natyre te vecante, per te bere te mundur vleresimin e plote te tyre eshte i nevojshem vlerësimi, inspektimi, perdorimi dhe testimi i tyre fizikisht konform dispozitave ligjore per mostrat ne menyre qe AK te sigurohet je do te kryeje

procedurat e trombektomise dhe DSA Cerebrale me artikuj cilesor dhe qe garantojne jeten e pacienteve per keto procedura jetike. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon, se është me vend të ndalet në faktin se kriteri i mësipërm është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet dhe është në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KSHA konstaton se artikujt objekt prokurimi janë të një natyre specifike për nderhyrjet DSA (Digital Subtraction Angiography) Cerebrale dhe Trombektomi dhe janë materiale me nderveprim të drejte për drejte me pacientin. Me konkretisht materialet objekt prokurimi futen në trupin e pacienteve përmes arterieve femorale dhe arrijnë deri në sistemin Neurovaskular përfshirë implante për arteriet karotide dhe katetere të ndryshëm për heqjen e trombeve nga sistemi neurovaskular. Lista e mostrave është përzgjedhur në përpjesëtim me objektin e prokurimit duke përzgjedhur numrin minimal të mostrave për çdo grup artikujsh. Në këto procedure prokurimi me artikuj të një natyre shumë specifike për procedura të një rëndësie shumë të lartë, është përdorur i gjithë kuadri ligjor në mënyrë që AK të mos kufizohet vetëm në katalog apo certifikata cilësie por duke kërkuar pjesërisht edhe mostra për verifikimin e cilësive dhe funksionalitetin konform specifikimeve teknike të kërkuara në mënyrë që këto procedura të kryhen pa rrezikuar jetën e pacienteve. KSHA gjykon gjithashtu se është me vend të ndalet në interpretimin e ligjit dhe akteve nenligjore mbi prokurimin publik ku në asnjë nen apo paragraf nuk përcaktohet që përdorimi i njerit prej kriterëve përjashton kriteret e tjera për atë kohë sa këto kritere janë në përpjesëtim me objektin, volumin dhe natyrën e kontratës. Duhet theksuar gjithashtu se procedurat ku do të përdoren këto materiale janë shumë delikate dhe emergjente për shpëtimin e jetës së pacienteve prandaj AK duhet të përdori gjithë kuadrin ligjor në mënyrë që të sigurohet mbi funksionalitetin dhe cilësinë e materialeve të kërkuara.

OE Ankimues nuk ka paraqitur asnjë provë apo argumentin se në çfarë mënyrë ky kriter kufizon garën por ka përdorur Vendime të KPP-së duke i cituar këto Vendime si shfuqizuese të neneve të LPP nr. 162 dt. 23.12.2020 dhe VKM Nr. 285 datë 19.5.2021. Në këtë rast, OE ankimues nuk ka paraqitur asnjë argumentim apo provë se cili nga elementet e listës së mostrave sic janë cmimi, koha e sigurimit të mostres, artikulli specifik, apo ndonjë element tjetër krijon kufizim apo diskriminim në këto gara. OE ankimues gjithashtu ngre pretendimin që për shkak të këtij kriteri, kufizohen ofertuesit potencial nderkombetar por pa sjelle asnjë provë apo fakt se ku e bazon këtë pretendim dhe duke mos paraqitur ankesën në rrugë zyrtare nga ofertuesit potencial nderkombetar. Në hartimin e Kriterëve për kualifikim, AK është bazuar vetëm në kuadrin ligjor të prokurimeve publike për të garantuar që materialet e kësaj procedure të jenë konform të gjitha kërkesave teknike në mënyrë që të ofrohet shërbimi i DSA Cerebrarle dhe Trombektomise për pacientet.

Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt, provë apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij se ky kriter është hartuar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pësha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin. Për sa është argumentuar më sipër, pretendimi i OE nuk qëndron.[...]”

III.2.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në nenin 40 pika 6 germa a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së

legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.8. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe kërkesa për dorëzimin e mostrave për artikujt të veçantë të përcaktuar në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit "formulari i specifikimeve teknike" është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, pretendimeve të ankimuesit, si dhe kthimit të përgjigjes lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor ka arritur të argumentojë, se përse është e nevojshme paraqitja e mostrave, duke e lidhur këtë me faktin, se materialet objekt - prokurimi kanë një natyrë të veçantë dhe për të bërë të mundur vlerësimin e plotë të tyre është i nevojshëm vlerësimi, inspektimi, përdorimi dhe testimi i tyre fizikisht konform dispozitave ligjore për mostrat, në mënyrë që AK të sigurohet që do të kryejë procedurat e trombektomisë dhe DSA Cerebrale me artikuj cilësorë dhe që garantojnë jetën e pacientëve për këto procedura jetike. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka argumentuar, se për shkak të specifikës së procedurës, ai nuk mund të kufizohet në kërkesat vetëm me paraqitjen e katalogëve apo certifikatave të cilësisë, por duke kërkuar pjesërisht mostra për verifikimin e cilësisë dhe funksionalitetin në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, në mënyrë që të

kryhen pa rrezikuar jetën e pacientëve, për shkak se procedurat ku do të përdoren këto materiale janë shumë delikate dhe emergjente për shpëtimin e jetës së pacientëve. Nga ana tjetër, vetë operatori ekonomik nuk ka arritur të argumentojë, se pse vendosja e këtij kriteri cenon konkurrencën apo pamundëson ofrimin e mallit të kërkuar, duke e lidhur kryesisht pretendimin e tij me vendime të mëparshme të KPP-së, si dhe me kufizimet e mundshme që mund t'u ndodhin ofertuesve ndërkombëtarë, por pa specifikuar se si mund të ndodhin këto kufizime, arsye këto të pamjaftueshme, përballë objektit dhe rëndësisë së kësaj procedure prokurimi dhe argumenteve të dhëna nga KSHA në lidhje me këtë pretendim. Vetë ligjvënësi në nenin 40 pika 6 të *lex specialis*, ka lënë të hapur mundësinë, që rast pas rasti, kur natyra dhe përmasat e kontratës e lejojnë autoritetin kontraktor, në mënyrë të justifikuar të mund të kërkojë paraqitjen e katalogëve/skedave teknike, si edhe mostrave, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së plotë të specifikimeve teknike të artikujve me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka arritur të argumentojë në mënyrë shteruese, se përse duhet të kërkohet paraqitja e mostrave të caktuara, duke e lidhur paraqitjen e tyre kryesisht me specifikat e procedurës, prandaj KPP e gjen të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave sipas artikujve që ka përcaktuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Trimed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84207-10-18-2023, me objekt “Blerje materiale për diagnostikimin e DSA Cerebrale dhe Trombektomi”, me fond limit: 65,870,925.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 24.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Trimed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84207-10-18-2023, me objekt “Blerje materiale për diagnostikimin e DSA Cerebrale dhe

Trombektomi”, me fond limit: 65,870,925.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal “Memorial” Fier.

3. Autoriteti kontraktor të publikojë në SPE, shtojcën sipas vendimit nr.1, datë 31.10.2023, të KSHA-së së autoritetit kontraktor, i cili ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

